



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 16 shkurt 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Fikrim Damka, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Valdet Hoxha, Drita Xheladini dhe Besnik Berisha nga MPB-ja; Valbon Bytyçi, Arvita Zyferi dhe Samir Zymberi nga ZKA-ja. Granit Fetahu dhe Hamdi Hyseni nga Policia e Kosovës.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.01.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, i ftuar z. Skender Hyseni, ministër;
4. Diskutim i aktivitetëve me prioritet për komisionin;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhja së mbajtura më 26.01.2017

Kryetari konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 26.01.2017, u aprovuan pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët se në këtë pikë të rendit të ditës është planifikuar të shqyrtohet raporti i Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015. Në këtë mbledhje nuk ishte prezent ministri i MPB-së, e sipas qëndrimit të deritashëm të komisionit raportet nuk mund të shqyrtohen pa prezencën e ministrit. Me këtë hapi diskutimin.

Enver Hoti, përsëriti qëndrimi e komisionit se pa prezencën e ministrit nuk mund të vazhdohet me diskutim të raportit të auditimit për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Synavere Rysha theksoi se është praktikë e komisionit që pa pjesëmarrjen e ministrit të MPB-së nuk mund të diskutohet raporti, megjithatë këtë pikë të rendit të ditës propozojë ta diskutojmë në takimin e radhës së KMFP-së.

Valdet Hoxha, zëvendësministër në MPB, tregoi se ministri i MPB-së sot gjendet në pikën kufitare me Serbinë, ku është planifikuar të vihet gurëthemeli i objektit për pikën e përbashkët doganore Kosovë-Serbi, sipas marrëveshjes së Brukselit.

Naim Fetahu theksoi se qëndrimi i KMFP-së është që raportet e auditimit për ministrinë mos të diskutohen pa prezencën e ministrave gjegjës.

Abdyl Ymeri theksoi se qëndrimet e komisionit nuk duhet të ndryshojnë, sa i përket mbajtjes së takimeve pa prezencën e ministrit.

Ali Sadriu theksoi se nuk është dashtë të thirret takimi kur keni pasur informata se ministri nuk mund të marrë pjesë në takim.

Përfundim

KMFP, vendosi që shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, ta shqyrtojë në njërin nga takimet e radhës të komisionit.

4. Diskutim i aktiviteteve me prioritet për komisionin

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët se GIZ ka përgatitur një plan të punës për sa i përket shqyrtimit të raporteve të auditimit për PVF-të e komunave për vitin 2015. Sipas këtij plani është bërë kategorizimi i komunave, dhe këto raporte do të shqyrtohen në një takim të përbashkët. Propozimi është të merren 7 komuna nga i gjithë rajoni, dhe të merret një komunë me shumicë të popullsisë serbe. Shpenzimet për këtë punëtori do i mbulojë GIZ-i.

Naim Fetahu shtoi se është mirë të përgatitet një propozim të na dërgohet paraprakisht dhe me pastaj të vendoset se si të vepohet në këtë aspekt.

Hajdar Beqa tha se pajtohem të vepohet në këtë mënyrë, megjithatë ne, si deputet, duhet t'i kemi komente e juaja paraprakisht për me mundur me i analizuar format dhe përmbajtjen e tyre.

Ali Sadriu kërkoi që të futet në këtë renditje edhe një komunë e mesme.

Abdyl Ymeri shtoi se çfarë kriteri do të përdoret për shqyrtim të raporteve të auditimit për komunat e mesme dhe të vogla?

Përfundim

KMFP vendosi që shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e 7 ose 8 komunave, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të shqyrtohen në një punëtori ka mesi i muajit mars 2017. Për formën e raportimit dhe arsyetimin e raporteve deputetët do të njoftohen paraprakisht.

5. Të ndryshme

Faton Topalli, kryetar, theksoi se a jeni të interesuar për t'i diskutuar edhe planet e veprimt për adresim të rekomandimeve nga viti paraprak. Me këtë e mbylli takimin.

Përfundim

KMFP vendosi që shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2015, të vazhdohet me shqyrtimin e tyre përderisa të vijë raportet e Auditimit të vitit 2016. Po ashtu në mbledhje të radhës të shqyrtohet edhe një plan i veprimt për adresim të rekomandimeve, për një Organizatë Buxhetore që ka dorëzuar planin e veprimt.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli